



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 176/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave në vende publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

### Arsyetim

Me datën 06.10.2013, subjekti politik PDK, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 06 Tetor 2013 në rrugën “Ismail Qemajli”, subjekti politik LDK në Ferizaj ka vendosur posterin e kandidatit për kryetar të kësaj komune në shenjat e publike të trafikut duke penguar orientimin e vozitësve, me të cilin veprim sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje ligjore e Rregullave Zgjedhore si Kodi Etik të Subjekteve Politike si dhe Rregullën nr. 01/2012 për Kategorizimin e Gjobave që parashihen me nenin 3 pika 2 e kësaj rregulle.

Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK, me datën 07.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.10.2013 deri në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK, lidhur me ankesën A.nr 176/2013, të paraqitur nga subjekti politik PDK, ku theksohet se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara sepse në fotot e ofruara si provë shihet qartë se posterat nuk janë vendosur në shenjat e komunikacionit siç aludohet në ankesë por posteri është vendosur në shtyllë elektrike e cila është aset i KEDS-it. Pra në foto shihet qartë se nuk është prekur fare shenja e komunikacionit.

Andaj me këtë rast subjekti politik LDK kërkon nga PZAP-i që këtë ankesa ta hudhë si të pabazë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Me ankesën e parashtruar nga subjekti politik PDK, pretendohet se anëtarët e subjektit politik të LDK-së, me datë 06 Tetor 2013 në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, subjekti politik LDK në Ferizaj ka vendosur posterin e kandidatit për kryetar të kësaj komune në shenjat e komunikacionit, andaj nisur nga kjo PZAP-i gjeti se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë ngase dëshmia e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk janë dëshmi të mjaftueshme me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nga fotografit e ofruara si provë nga subjekti politik i PDK shihet se posteri është i ngjitur në shtyllë elektrike mu ashtu siç pretendon LDK në përgjigjen e saj në ankesë dhe se ky pretendim i PDK -së u vlerësua si i pabazë dhe i pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse për shkeljen e pretenduar, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe në kuptim të nenit 115.1, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 176/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*